EU4GREEN

WP-1-6 KODET E PRAKTIKËS SË MIRË BUJQËSORE - ELEMENTET KYÇE DREJT EFIÇIENCËS NË PËRDORIMIN E AZOTIT

Shtator 2025

Funded by the European Union

With funding from
Austrian Development Cooperation

umweltbundesamt
ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA

DEKLARATË PËR MOSPRANIM PËRGJEGJËSIE:
Projekti i zbatuar nga Umweltbundesamt Austria, financohet nga Bashkimi Evropian dhe Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Umweltbundesamt GmbH. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë sikur pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian, Qeverisë Austriake apo të Qeverive të Ballkanit Perëndimor. Ky dokument, çdo referencë për përfituesit në Ballkanin Perëndimor apo hartat e përfshira në të, nuk cenojnë statusin apo sovranitetin e asnjë territori, përcaktimin e kufijve ose ndarjeve kufitare ndërkombëtare dhe emrin e asnjë territori, qyteti apo zone. Përcaktimi për Kosovën jepet pa paragjykim për qëndrimet mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 1244/1999, dhe Opinionin e GJND-së lidhur me deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Shenja e botuesit:
Zotëruesi dhe redaktori:
Umweltbundesamt GmbH
Spittelauer Lände 5, 1090 Vienna, Austria

Autorët:
Bettina Schwarzl, Manuela Bürgler (Umweltbundesamt GmbH)

Shtator 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Objektivat dhe mënyra e përdorimit të broshurës 3

1.1 Menaxhimi i azotit si kërkesë e Direktivës së BE-së për Nitratet (91/676/KEE) 3
1.2 Përkufizime 4
1.3 Si mund të ndihmojë kjo broshurë?..... 4
1.4 Përse ka rëndësi Menaxhimi i Azotit dhe si përfitojnë fermerët? 5

2. Gjashtë elementet kyçe të kodit të praktikave të mira bujqësore sipas Direktivës së Nitrateve të BE-së (91/676/KEE) 6

2.1 Periudhat kur hedhja e plehut është e papërshtatshme 6
2.2 Hedhja e plehut në tokë shumë të pjerrët 7
2.3 Hedhja e plehut në tokë të ngopur me ujë, të përmbytur, të ngrirë ose të mbuluar me borë 8
2.4 Hedhja e plehut pranë rrjedhave ujore..... 9
2.5 Kapaciteti dhe ndërtimi i mjeteve të magazinimit të plehrave organike të kafshëve.....11
2.6 Procedurat për hedhjen e plehut, përfshirë normën dhe njëtrajtshmërinë e shpërndarjes 13

Literatura 14
Shtojcë: Sekretimi i azotit dhe prodhimi i plehut organik nga kafshët.....15

umweltbundesamt
ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA
With funding from
Austrian Development Cooperation
Funded by the European Union

1. OBJEKTIVAT DHE MËNYRA E PËRDORIMIT TË BROSHURËS

1.1 Menaxhimi i azotit si kërkesë e Direktivës së BE-së për Nitratet (91/676/KEE)

Direktiva për Nitratet synon të mbrojë cilësinë e ujit në mbarë Evropën duke parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore me nitratet nga burimet bujqësore dhe duke nxitur përdorimin e kodeve të praktikave të mira bujqësore për menaxhimin e përdorimit të azotit.

Direktiva synon të ulë ndotjen e ujit nga nitratet e përdoruara në bujqësi, duke;

- monitoruar përqendrimet e nitrateve në trupat ujorë,
- përcaktuar zona të cenueshme nga nitratet dhe
- përcaktuar kode të praktikave të mira bujqësore dhe masa për parandalimin



Ulja e humbjes së lëndës ushqyese në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore do të thotë se fermerët kanë më shumë lëndë ushqyese në dispozicion, duke pakësuar nevojën për inpute të shtrenjta të plehrave minerale. Synimi është rritja e efiçiencës së azotit në nivel ferme dhe që cikli i azotit aty të mbyllet sa më shumë të jetë e mundur.

Azoti është element thelbësor për prodhimin e kulturave bujqësore dhe mund të përdoret në formën e plehrave minerale që gjenden në treg, por edhe në formën e plehrave organike si plehu nga kafshët, kompostimi apo llumrat fekale. Një tjetër burim azoti në ekosistemet bujqësore është fiksimi i azotit biologjik nga bimët bishtajore si jonxha, tërfili, përzierjet tërfil-bar, soja, bizelja dhe fasulja e fushës.
Megjithatë, kur përdoret jashtë mase ose në kushte jo të përshtatshme, azoti mund të kthehet në burim madhor të ndotjes ujore dhe ajrore me ndikime negative si tek biodiversiteti, ashtu edhe tek klima.
Ndotja e ujit do të thotë se nitratet humbin në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Nitratet mund të depërtojnë nga toka në ujërat nëntokësore. Vërshimet e ujërave sipërfaqësore dhe erozioni i tokës mund të sjellin humbje të nitrateve në ujërat sipërfaqësore. Ndotja e ajrit shkaktohet nga humbjet e azotit të gaztë në formën e amoniakut, kryesisht nga plehu i kafshëve dhe plehrat minerale, veçanërisht urea, dhe në masë më të vogël nga toka. Për më tepër, humbjet e azotit të gaztë nga toka mund të jenë në formën e oksidit azotik me rëndësi për çështjet klimatike, kryesisht pas plehërimit në tokë të lagur dhe të ngjeshur me kushte anaerobike (pa ajër - çnitratizim i paplotë).

1.2 Përkufizime

Plehra të lëngëta kafshësh janë përbërësit e lëngshëm të jashtëqitjeve të gjësë së gjallë (urina) kur mblidhet veçmas nga përbërësit e ngurtë.
Plehra të ngurta kafshësh janë përbërësit e ngurtë të jashtëqitjeve të gjësë së gjallë. Shpesh këto përzihen me materiale që përdoren për shtrimin e kafshëve në stallë, si psh. kashta.
Llumi është përzierja e përbërësve të lëngshëm dhe të ngurtë të jashtëqitjeve të gjësë së gjallë (urina + plehu i kafshëve së bashku). Ndonjëherë kjo përzierje hollohet me ujë që të shpërndahet në mënyrë më të njëtrajtshme si pleh në fusha.

1.3 Si mund të ndihmojë kjo broshurë?

Synimi i broshurës është të mbështesë fermerët në Kosovë të rrisin eficiencën e azotit duke mbyllur ciklet e azotit në fermë dhe duke parandaluar humbjet e azotit në mjedis.
Gjashtë elementet kyç të Direktivës së Nitrateve të BE-së tregojnë si të ruhet azoti për fermën dhe për kulturat e mbjella (si burim ushqimesh dhe si ushqim për bagëtitë), duke pakësuar kështu humbjet e azotit në ajër ose në ujë. Broshura rendit gjashtë elementet e Kodeve të Praktikës së Mirë Bujqësore sipas Direktivës së Nitrateve:

1. Periudhat kur hedhja e plehut është e papërshtatshme
2. Hedhja e plehut në tokë shumë të pjerrët
3. Hedhja e plehut në tokë të ngopur me ujë, të përmbytur, të ngrirë ose të mbuluar me borë
4. Hedhja e plehut pranë rrjedhave ujore

umweltbundesamt ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA
With funding from Austrian Development Cooperation
Funded by the European Union

5. Kapaciteti dhe ndërtimi i mjeteve për magazinimin e plehrave organike të kafshëve
6. Procedurat për hedhjen e plehut, përfshirë normën dhe njëtrajtshmërinë e shpërndarjes.

Për më tepër, kjo broshurë përfshin tabela me sasitë mesatare të azotit që del nga kafshët sipas kategorive të tyre dhe kapacitetin e magazinimit të plehut të kafshëve.
Kjo broshurë i drejtohet fermerëve dhe këshilltarëve bujqësorë të interesuar në përmirësimin e menaxhimit të ushqyesve në ferma.

1.4 Përse ka rëndësi Menaxhimi i Azotit dhe si përfitojnë fermerët?

Ndotja e tokës, ujit dhe ajrit nga depërtimi dhe vërshimi i plehrave nuk ka ndikim vetëm në mjedis, por edhe mbi shëndetin njerëzor të brezave aktualë dhe të ardhshëm. Praktikat e përgjegjshme bujqësore sigurojnë ujë të pijshëm të pastër dhe tokë pjellore për furnizim të sigurt me ushqim.
Aspekti financiar është konsideratë veçanërisht e rëndësishme për fermerët. Humbja e lëndëve ushqyese për shkak të hedhjes së papërshtatshme të plehrave mund të sjellë çuarjen dëm të burimeve me vlerë për fermën. Shfrytëzimi me efiçiencë i plehrave kursen kostot shtesë për plehra minerale dhe siguron prodhim të qëndrueshëm. Kjo mund të rezultojë në të ardhura më të larta për fermerët dhe në situata më të sigurta financiare të familjeve fermere. Në fermat e blegtorisë, plehu i kafshëve ka kosto të ulët dhe është burim me vlerë azoti.

Humbja e lëndëve ushqyese ↓

Kostot e plehut artificial ↓

Rendimenti i kulturës ✓

Të ardhurat e fermerëve ✓

2. GJASHTË ELEMENTET KYÇE TË KODIT TË PRAKTIKAVE TË MIRA BUJQËSORE SIPAS DIREKTIVËS SË NITRATEVE TË BE-SË (91/676/KEE)

2.1 Periudhat kur hedhja e plehut është e papërshtatshme

Çfarë duhet bërë?
Të hidhen plehra vetëm gjatë sezonit të rritjes, në kushte të përshtatshme klimatike.

- ⇨ Të synohet plehërimi në periudhat kur bimët kanë nevojë për azot. Kjo parandalon humbjen e lëndëve ushqyese në ujë (p.sh. nuk hidhet pleh në dimër ose gjatë thatësirave në verë)
- ⇨ Modele të sakta për përcaktimin e këtyre periudhave nuk ekzistojnë, sepse çdo rajon ka kërkesa të veçanta. Ato varen nga praktikat bujqësore, kushtet e klimës dhe tokës, kur humbjet e lëndëve ushqyese janë më të mundshme.

©Mevlida Dudo-Suvakic

Çfarë do të thotë kjo për fermën time?

- ⇨ Përcaktoni kapacitetin e nevojshëm për magazinim të plehrave për të shmangur hedhjen e plehut të kafshëve në këto periudha (Elementi 5).

FAKTORËT NDIKUES PËR PËRCAKTIMIN E PERIUDHËS:

1. Periudhat me normë të ulët të depërtimit të ujit: shkrifërimi, formimi i kores dhe tejngopja e tokës me ujë.
2. Periudhat kur rritja e kulturave sapo ka nisur apo pengohet nga i ftohti, ose kur toka lihet ugar.
3. Periudhat kur reshjet (përfshirë shkrirjen) tejkalojnë normën e depërtimit të ujit në tokë, në varësi të:
   - tepricës mesatare të reshjeve mujore
   - modeleve të përthithjes në kohë dhe kapacitetit të përthithjes së llojeve të veçanta të kulturave
   - pranisë apo mungesës së kulturave mbuluese dhe ndarjet me bimësi

KOSOVA:

Të shmanget hedhja e plehrave në periudhën **nëntor-shkurt**. Kështillë: Të pakësohet plehërimi në verë. Niveli i rritjes së bimëve ulet për shkak të reshjeve të pakta.

umweltbundesamt ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA
With funding from Austrian Development Cooperation
Funded by the European Union

2.2 Hedhja e plehut në tokë shumë të pjerrët

Çfarë duhet bërë?
Pas hedhjes së plehut në tokë kodrinore apo në shpat (shpate me pjerrësi prej 15% ose më shumë), reshjet ose erozioni i tokës mund të shkaktojë vërshimin e lëndëve ushqyese (azot dhe fosfor). Kjo rezulton në humbjen e ushqyesve të rëndësishëm për rritjen e bimës. Për më tepër, plehrat e shpëlara transportohen në trupat ujorë përreth duke i ndotur ato.

ÇFARË MUND TË BËJMË PËR PAKËSIMIN E RISKUT TË VËRSHIMIT TË LËNDËS USHQYESE NË SIPËRFAQE:

- Krijoni zona me bimësi gjatë gjithë vitit (p.sh. synoni për kullota në vend të tokave të punuara)
- Mbulimi i shpejtë me tokën i plehut pas hedhjes (veçanërisht për plehrat e lëngshme, plehrat nga biogazet, mbetjet e fermentimit, plehrat e pastabilizuara të uresë dhe llumrat fekale të paavulluara)
- Ndani sasitë e plehut (hedhje e pjesshme herë pas here)
- Masa të veçanta mbrojtjeje për kulturat me zhvillim veçanërisht të vonë në pranverë (p.sh. panxhari, misri, batha, soja): Kultivimi në të gjithë shpatin ose me metoda të tjera që parandalojnë rrjedhën e ujit (p.sh. me mulçim dhe pa e punuar tokën), si dhe kanale të kryqëzuara me mbulesë bimore

Fusha bujqësore me pjerrësi të madhe ku plehërimi mund të jetë problematik

2.3 Hedhja e plehut në tokë të ngopur me ujë, të përmbytur, të ngrirë ose të mbuluar me borë

Çfarë duhet bërë?
Toka e ngrirë dhe mbulesa me borë kufizojnë lëvizjen e lëndëve ushqyese në tokë, duke rritur tej mase riskun që lëndët ushqyese të transportohen në ujërat sipërfaqësore nga vërshimi. E njëjta gjë vlen për tokën e tejngopur me ujë. Kjo ndodh shpesh pasi toka është përmbytur si pasojë e reshjeve të shumta të pazakonta ose kur lumenjtë dhe përrenjtë dalin nga shtrati. Për këtë arsye, në këto kushte nuk duhet të plehërohet. Kjo vlen në mënyrë të njëjtë si për arat ashtu edhe për livadhet. Për më tepër, përdorimi i makinerive të rënda në kushte shumë të lagështa mund të rezultojë në ngjeshjen tej mase të tokës.

Në Kosovë ka rrezik nga përmbytjet, gjatë të cilave plehërimi është i ndaluar me anë të Ligjit për Ujërat (Ligji Nr. 04/L-147, 2013). Më poshtë jepen disa tregues të kushteve që nuk favorizojnë plehërimin:

Toka e tejngopur me ujë: toka është aq e lagët sa nuk mund të përthithë më tepër ujë, për shembull pas reshjeve të mëdha. Rekomandohet kontrolli i parashikimit të motit për 48 orët e ardhshme përpara plehërimit. Kjo mund të parandalojë humbjen e plehrave me vlerë nga vërshimet.

Toka e përmbytur: toka përmbytet për shkak të daljes së trupave ujorë nga shtrati dhe pamundësisë për të përthithur më ujë. Plehërimi në zonat me përmbytje të shpeshta duhet të ulet vetëm në sezonin e rritjes, kur përthithja nga kulturat është e madhe.

Toka e mbuluar me borë: nëse më pak se gjysma e tokës në fushë nuk është e mbuluar me borë.

Toka e ngrirë: nëse toka nuk shkrin gjatë ditës.

umweltbundesamt
ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA
With funding from
Austrian Development Cooperation
Funded by the European Union

2.4 Hedhja e plehut pranë rrjedhave ujore

Çfarë duhet bërë?
Zonat tampon mbrojnë trupat ujorë nga vërshimi i plehrave. Kështu, shmangni depërtimin e drejtpërdrejtë të lëndëve ushqyese në ujërat sipërfaqësore duke krijuar distanca të caktuara ndërmjet zonës së plehëruar dhe trupit ujor sipërfaqësor.

Rekomandimi:
Krijoni mbulesë të përhershme me bimësi rreth 3 m nga buza e trupit ujor. Kjo zonë nuk duhet të plugohet dhe duhet ripërtërirë jo më shumë se një herë në 5 vjet. Kjo masë ndihmon në parandalimin e humbjes së plehrave të dobishme në trupin ujor.

Shembull: Gjerësitë e zonave tampon në Austri	Pjerrësia në %	Distanca nga trupat ujorë pa rrjedhje	Distanca nga trupat ujorë me rrjedhje
Arë	< 10 %	20 m	10 m
		10 m (mbuluar me bimësi të gjallë gjatë gjithë vitit)	3 m (mbuluar me bimësi të gjallë gjatë gjithë vitit)
	> 10 %	20 m	5 m (mbuluar me bimësi të gjallë gjatë gjithë vitit)
Livadhe	< 10 %	10 m	3 m
	> 10 %	20 m	5 m

Pikat e referencës për distancat minimale nga rrjedhat ujore



©Umweltbundesamt (ndryshuar nga Hölzl 2024)

Në Kosovë janë të fermat me ngastra toke të përmasave të vogla. Këto ferma ndikohen veçanërisht nga kërkesat e gjerësisë së rripave tampon. Për të parandaluar humbjet jo proporcionale të prodhimit, gjerësia e zonave tampon mund të ulet për fushat e ngushta me rrjedha ujore përgjatë tyre. Në këto raste rekomandohet që punimi të kryhet paralel buzës së rrjedhës ujore, duke minimizuar kështu vërshimin e lëndëve ushqyese në ujë.

umweltbundesamt
ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA
With funding from
Austrian Development Cooperation
Funded by the European Union

2.5 Kapaciteti dhe ndërtimi i vendruajtjeve të plehrave organike të kafshëve

Çfarë duhet bërë?
Ruajtja e sigurt dhe e mbrojtur e plehrave organike të kafshëve për parandalimin e ndotjes së ujit nga rrjedhat dhe depërtimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

- ⇨ Kushtet e vendruajtjeve ose zonave të magazinimit: hapësira që nuk rrjedhin, njësi me beton që i rezistojnë ujit, me shkarkim të kontrolluar të rrjedhës nga mbetjet në gropë mbledhëse që nuk lejon rrjedhjen
- ⇨ Kapacitet i mjaftueshëm i magazinimit parandalon plehërimin në periudha të papërshtatshme.

PËRLLOGARITJA E KAPACITETIT TË MAGAZINIMIT

- Kapaciteti mbajtës duhet të përshtatet me periudhën më të gjatë në të cilën plehërimi nuk është i përshtatshëm ➔ Elementi i parë kyç
- Kapaciteti minimal i magazinimit për plehun e kafshëve në fermë është 6 muaj
- Mos harroni të llogarisni këtu edhe sasinë e reshjeve dhe të ujit nga proceset e pastrimit

Këshillë: SI TË PËRLLOGARISIM KAPACITETIN PËR CISTERNËN E MAGAZINIMIT TË PLEHUT TË KAFSHËVE

Sasitë e mbledhjes së plehut të kafshëve për secilën kategori blegtorie përfshihen në Shtojcë (kujdes: përdorni sasitë e prodhimit të plehut të kafshëve sipas sistemit të plehut të kafshëve në fermën tuaj, p.sh. llum ose pleh i ngurtë ose i lëngshëm i kafshëve)

Prodhimi i plehut nga kafshët - për kafshë për muaj x numrin e kafshëve x 6 muaj
= Kapaciteti minimal i magazinimit për 6 muaj (m^3)

Çfarë do të thotë kjo për fermën time?

Formulat dhe njësitë për përllogaritjen:

- ⇨ Plehu organik gjysmë i lëngshëm 1t = 1 m^3
- ⇨ Plehu i ngurtë organik: Gjedhë: 0.83 t = 1 m^3. Derra: 0.91 t =1 m^3, Shpendë: 0.5 t = 1 m^3, Dele/Dhi: 0.7 t = 1 m^3

Përllogaritja e sipërfaqes për zonën e plehrave nga kafshët

Totali i plehut të ngurtë të kafshëve (m^3) për një periudhë 6-mujore
---------- = sipërfaqja për hapësirën e vendruatjes së plehut të kafshëve (m^2)

STRATEGJIA E KOSOVËS PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL (SBZHR) 2022-2028

Ndërhyrja e propozuar: Zhvillimi rural: Grante për investime në asetet fizike të fermave bujqësore

- Investime në magazinimin e plehut të kafshëve

Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2022-2028. Republika e Kosovës. https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/STRATEGJIA-2022-2028-FINAL-ENG-Web-Noprint-final-PDF.pdf

Objektet e magazinimit të plehut të kafshëve: disa rekomandime:

- ⇨ Përdorni materiale që parandalojnë rrjedhjen në mjedisin përreth
- ⇨ Baza e objektit të magazinimit duhet të ndërtohet me beton, plastikë ose gomë.
- ⇨ Muret anësore duhet të jenë beton, tullë, plastikë, gomë, ose metal.
- ⇨ Njëra anë e objektit duhet të sigurojë hapësirë të përshtatshme për largimin, trajtimin dhe transportin e plehut të kafshëve.
- ⇨ Objekti i magazinimit të plehut të kafshëve duhet të mbulohet me plastikë ose gomë dhe mbi të të hidhet tokë për minimizimin e shkarkimit të gazrave.

(projekt udhëzim administrativ i vitit 2025, në hartim e sipër)

umweltbundesamt ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA
With funding from Austrian Development Cooperation
Funded by the European Union

2.6 Procedurat për hedhjen e plehut, përfshirë normën dhe njëtrajtshmërinë e shpërndarjes

Çfarë duhet bërë?
Procedurat për plehërimin, përfshirë normën dhe uniformitetin e shpërndarjes, si të plehut kimik ashtu edhe atij organik nga kafshët, që do të mbajnë në nivel të pranueshëm humbjen e ushqyesve në ujë

⇨ Direktiva e Nitrateve përcakton kufirin maksimal të sasisë së azotit të përdorur nga plehu i kafshëve: 170 kg N për hektar në vit.

Këshillë: SI TË PËRLLOGARISIM SASITË E PËRGJITHSHME TË AZOTIT NGA PLEHU I KAFSHËVE TË DISPONUESHME NË FERMË NË VIT

Sasitë e azotit për kategori kafshësh dhe në vit përfshihen në shtojcë

Sekretimi i azotit për kafshë X numrin e kafshëve = azoti gjithsej (kg) në plehun e kafshëve në vit

ÇFARË DUHET MARRË PARASYSH?

- Koeficientët e largimit të azotit sipas kategorive të kafshëve për përllogaritjen e sasive të disponueshme të azotit në plehun e kafshëve
- Shpërndarja e plehrave
- Saktësia e përhapjes së plehrave: pajisjet duhet të jenë të përshtatshme për pjesën dhe të përhapin plehrat siç duhet
- Përfshirja e plehrave
- Kushtet e motit dhe



©Umweltbundesamt/Manuela Bürgler

LITERATURA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2025). Projekt udhëzim administrativ: Specifikimet teknike për ndërtimin e objekteve të magazinimit të plehut të kafshëve, në hartim e sipër.

Komisioni Evropian (1991). Direktiva e Këshillit, 91/676/KEE e datës 12 dhjetor 1991, për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga nitratet që burojnë nga bujqësia. Në internet: https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/1991/676/oj/eng

Bundesministers für Land- und Forstwirtschaft, Regionen und Wasserwirtschaft (2022). Verordnung des Bundesministers für Land- und Forstwirtschaft, Regionen und Wasserwirtschaft über das Aktionsprogramm zum Schutz der Gewässer vor Verunreinigung durch Nitrat aus landwirtschaftlichen Quellen (Nitrat-Aktionsprogramm-Verordnung – NAPV). Në internet: https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=20012132

Hölzl (2024). Ausbringungsverbote und Sperrfristende gem. NAPV sowie Abstandsauflagen zu Oberflächengewässern incl. GLÖZ 4 und Gewässer-Definition. Landwirtschaftskammer Oberösterreich: Abteilung Pflanzenbau - Boden.Wasser.Schutz.Beratung, Linz.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (2021): Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2022-2028. Republika e Kosovës. https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/STRATEGJIA-2022-2028-FINAL-ENG-Web-Noprint-final-PDF.pdf

umweltbundesamt
ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA

With funding from
Austrian Development Cooperation

Funded by the European Union

SHTOJCË: SEKRETIMI I AZOTIT DHE PRODHIMI I PLEHUT ORGANIK NGA KAFSHËT

Koeficientët e sekretimit të azotit dhe sasitë e prodhimit të plehut nga kategoritë e kafshëve në Kosovë. Burimi i të dhënave: Në momentin e hartimit, vlerat e posaçme (sasitë e azotit në plehun e kafshëve, prodhimi i plehut për kafshë) nuk janë të disponueshme në Kosovë. Për këtë arsye, në këtë tabelë janë përdorur vlerat e Malit të Zi (Rregullorja për parimet e praktikave të mira bujqësore për hedhjen e plehrave, "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, Nr. 29/2014)

Kategoria e gjësë së gjallë	Largimi i azotit në kg N në vit për kafshë	Prodhimi i plehut për kafshë (m^3) në muaj PLEH I NGURTË	Prodhimi i plehut për kafshë (m^3) në muaj PLEH I LËNGËT	Prodhimi i plehut për kafshë (m^3) në muaj LLUM
Gjedhë				
Gjedhë më pak se 1 vjeç	28.0	0.5	0.1	0.9
Gjedhë 1-2 vjeç	49.0	0.9	0.2	1.2
Gjedhë mashkull më shumë se 2 vjeç	70.0	1.3	0.3	1.7
Gjedhë femër më shumë se 2 vjeç	56.0	1.1	0.3	1.3
Gjedhë qumështi	70.0	1.3	0.3	1.7
Dema mbarështimi	98.0	1.9	0.5	2.3
Derra				
Gica (më pak se 20 kg)	1.6	0.03	0.01	0.03
Derra mbarështimi	32.0	0.5	0.1	0.7
Dosa mbarështimi	24.0	0.4	0.1	0.5
Derra për majmje	12.0	0.2	0.1	0.25
Delet dhe dhitë				
Dele	7.0	0.1	0.03	0.2
Dhi	3.5	0.1	0.03	0.2
Shpendë				
Zogjtë e pulës	0.2	0.003	0.001	0.004
Pulë për vezë	0.3	0.01	0.001	0.01
Gjela deti	1.7	0.03	0.01	0.03
Lepuj dhe shpendë gjahu	0.2	0.003	0.001	0.003
Kuaj				
Mëz < 1 vjeç	30.0	0.7	0.2	0.8
Kuaj	72.0	1.6	0.4	2.0

Mund të aksesoni **Përllogaritësin e Plehut të Kafshëve** pa pagesë (dokument Excel-i) nëse skanoni këtë kod QR, i cili ju ndihmon në përllogaritjen e **kapacitetit të magazinimit për plehun e kafshëve** dhe **sasisë së azotit në plehun e kafshëve**:

umweltbundesamt
ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA

With funding from
Austrian Development Cooperation

Funded by the European Union

Funded by the European Union

With funding from Austrian Development Cooperation

umweltbundesamt ENVIROMENT AGENCY AUSTRIA

EU4GREEN